

RAPORTI VJETOR 2015



2015
QERSHOR



Të dashur klientë, miq e bashkëpunëtorë të EUROSIG,

Është kënaqësi që nëpërmjet këtij mesazhi përshëndetjeje, të ndaj me Ju suksesin e arritur nga EUROSIG, gjatë vitit 2015.

Qeverisja efektive e shoqërisë, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG, ka qenë, është dhe do të jetë prioritet kryesor i punës sonë.

Gjatë gjithë viteve të veprimtarisë së EUROSIG, kemi treguar se jemi gjithmonë me vizion, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecuar me kërkesat e tregut dhe nevojat e klientëve. Hartimi dhe ofrimi i produkteve novatore, përkujdesja maksimale ndaj klientit, pagesa në kohë e dëmeve ka përmbushur synimin tonë që t'i bëjmë njerëzit të ndjehen të qetë dhe të sigurtë, përtej marrëdhënies formale të biznesit.

Dëshiroj të theksoj se, megjithë ndikimin jo aq të favorshëm të faktorëve të jashtëm, në sajë të strategjisë efektive që zbatuam, kemi kapërcyer me sukses sfidat e tregut të sigurimeve. Në krahasim me vitin 2014, u rritëm me 47,24%, ose 23,81% më shumë se mesatarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, duke arritur kështu një volum primesh bruto prej 1 985 090 000 lekë.


Këto rezultate shumë të mira financiare, investimi në blerjen e kompanisë "Dardania" (sot EUROSIG Kosova), në Republikën e Kosovës, dhe blerja e shoqërisë INSIG, me aktivitet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, kanë ndikuar në konsolidimin e vazhdueshëm të pozicionit të EUROSIG në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Rezultatet pozitive që ka arritur EUROSIG janë provë e bashkëpunimeve të suksesshme që kemi përforcuar përgjatë këtij viti me klientët dhe partnerët tanë, si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe të gjithë stafit të EUROSIG.

Gjejmë rastin të falënderojmë klientët, aksionarët, partnerët e biznesit, për besimin që na kanë dhënë, si dhe punën e çmuar të stafit të EUROSIG që ka arritur të përmbushë pritshmëritë tona.

I bindur në qëndrueshmërinë e besimit që na keni dhënë, Ju ftojme në rrugëtimin tonë të përbashkët gjatë vitit 2016.

Vasil PILO
Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës





Xhevdet KOPANI
Drejtor i Përgjithshëm

Viti 2015 ka qenë një vit i suksesshëm për industrinë e sigurimeve, duke shënuar rritje të treguesve në tërësi. Gjatë këtij viti, tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 24,43%, në krahasim me vitin 2014, kurse vlera e dëmeve të paguara u rrit me 28,3%.

Shoqëria EUROSIG, si pjesë e rëndësishme e këtij tregu arriti t'i realizojë dhe t'i tejkalojë objektivat e planifikuara për vitin 2015. Gjatë vitit 2015, treguam jo vetëm qëndrueshmëri, por dhe rritje të treguesve, krahasuar me vitin 2014. Realizuar mbi 47% më shumë prime, krahasuar me vitin 2014, duke u renditur si shoqëria me rritjen më të lartë në industrinë e sigurimeve. Tashmë, Shoqëria EUROSIG ka startuar dhe po ecën e sigurtë drejt të qenit lider në industrinë e sigurimeve. Ne jo vetëm që u zgjeruam në rajon, por po performojmë suksesshëm.

Rezultatet pozitive të Shoqërisë EUROSIG, janë vlerësuar pozitivisht nga institucione të specializuara kombëtare dhe partnerët tanë ndërkombëtar, vlerësime që na bëjnë më të përgjegjshëm në rrugëtimin tonë në të ardhmen. Shoqëria EUROSIG, edhe gjatë vitit 2015, dëshmoj se mbetet shoqëri e fokusuar tek klienti, shërbimi ndaj tyre, dëmshpërblimi real dhe në kohë i dëmeve. Vlera e dëmeve të paguara është rritur në masën 162%, në krahasim me vitin 2014. Kjo përkujdesje ndaj klientëve është dhe sekreti i rezultateve në rritje të EUROSIG.

Të gjithë këta tregues pozitiv janë realizuar falë përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të shoqërisë, kujdesit dhe mbështetjes së aksionarve dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Qëllimi i Shoqërisë EUROSIG ka qenë dhe mbetet puna në ekip, menaxhimi efikas, përgjegjshmëria e lartë në shërbimin ndaj klientit. Kjo do të jetë në themel të punës tonë edhe gjatë vitit 2016.

Objektivat tona për vitin 2016 janë të arritshme dhe ambicioze. Ne synojmë të jemi lider në industrinë financiare të sigurimeve, si një shoqëri e orientuar nga klienti, si një shoqëri që prodhon siguri, tregon besueshmëri dhe është një vlerë e shtuar në shoqërinë shqiptare.



faqe 1

Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës

Qeverisja efektive e shoqërisë, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG, ka qenë...



faqe 5

Struktura Organizative e EUROSIG

EUROSIG i konsideron burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë. Për këtë arsye EUROSIG investon sistematikisht...



faqe 8

EUROSIG nëpërmjet shifrave

Shoqëria EUROSIG për vitin 2015 ka performuar pozitivisht, duke treguar qëndrueshmëri, rritje dhe standarde të larta.



faqe 2

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

Viti 2015 ka qenë një vit i suksesshëm për industrinë e sigurimeve, duke shënuar rritje të treguesve në tërësi. Gjatë këtij viti, tregu i sigurimeve...



faqe 12

Momente të rëndësishme

Në tërë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2015, shoqëria EUROSIG ka garantuar një shërbim të shpejtë dhe profesional ndaj klientëve, duke rritur shkallën e investimeve në modernizimin...



faqe 14

Ne jemi EUROSIG

Shoqëria Aksionare EURO-SIG është themeluar, më 16. 07. 2004, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më 19. 07. 2004, me NUIS K41926801W. Drejtoria e Përgjithshme...



faqe 4

Vizioni, Misioni, Vlerat e kompanisë

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke...



faqe 20

Përgjegjësia sociale

EUROSIG i ka kushtuar përgjegjësisë sociale një vëmendje shumë të madhe. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, Z. Kadri MORINAJ, EUROSIG ka...



faqe 30

Objektivat për vitin 2016

Rritja me 20%, krahasuar me vitin e mëparshëm, e primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike...

MISIONI, VIZIONI, VLERAT E SHOQERISE

VIZIONI

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.

MISIONI

Të sigurojmë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, duke përsosur shërbimin, cilësinë, profesionalizmin, etikën, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet;

Të ofrojmë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;

Të marrim reagime (feedback) nga klientët me forma e metoda bashkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.

VLERAT E SHOQËRISË

Shoqëria EUROSIG, tashmë ka një emër në industrinë e sigurimeve dhe përbën një vlerë të shtuar në këtë industri. Përvoja 12 vjeçare në fushën e sigurimeve jo vetëm i ka konsoliduar këto vlera, por i ka bërë të qëndrueshme dhe që ndikojnë

drejtëpërdrejtë në vlerën e shoqërisë. Filozofia e EUROSIG-ut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe në të ardhmen.

Shtirja e EUROSIG-ut në të gjithë vendin dhe burimet njerëzore të punësuar shtojnë vlerat dhe rritin mundësitë për suksese në vijimësi. Asetet humane po konsolidohen, duke i shërbyer sfidave të së ardhmes.

Pozicionimi dhe besueshmëria e arritur në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme, relativisht të shpejtë, përmirësimi i imazhit të EUROSIG-ut, zgjerimi i rrjetit të shitjes së produkteve, investimet e bëra në teknologjinë e informacionit, kanë ardhur si rezultat i një drejtimi të suksesshëm menaxherial, pune të vazhdueshme nga një staf i kualifikuar, dinamik dhe profesionist i vërtetë në fushat që veprojnë.

Drejtesit dhe punonjësit e EUROSIG-ut janë të vëmendshëm ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

Performimi i EUROSIG në raport me industrinë dhe historinë e saj, me rritje dhe konsolidim në tregun e sigurimeve, përbëjnë një vlerë që do të ndikojë pozitivisht në ecurinë e shoqërisë në të ardhmen.



STRUKTURA ORGANIZATIVE E EUROSIG



EUROSIG i konsideron burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë. Për këtë arsye EUROSIG investon sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve. Aktualisht EUROSIG është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me degë, agjenci dhe pika shitjeje e përfaqësimi.

Në EUROSIG, ne besojmë që rruga më e shpejtë për rritje është ekspozimi drejt sfidave të reja. Një shembull i mirë i këtij promovimi nga brenda është zhvillimi i eksperiencës sonë. Punonjësit e kualifikuar, të cilët po rriten në shkollat e EUROSIG dhe kanë treguar një performancë të vazhdueshme, janë konkretisht menaxherë departamentesh dhe degësh në të gjithë Shqipërinë.

Suksesi profesional i punonjësve të EUROSIG është i garantuar edhe përmes trajnimeve të vazhdueshme të menaxherëve dhe punonjësve të strukturave qendrore dhe vendore. Gjatë vitit 2015, janë trajnuar në mënyrë të përqendruar dhjetëra punonjës, drejtues dhe specialistë të shitjes së degëve dhe agjencive, për zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në aktet e reja

ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG. Ndërkohë që trajnime më specifike u janë ofruar individualisht punonjësve të rinj të rekrutuar, si dhe atyre që kalojnë në pozicione të reja pune.



QEVERISJA E EUROSIG

Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës, si organi qeverisës i Shoqërisë, mbikëqyr punën menaxheriale dhe merr vendime për probleme të rëndësishme të nivelit strategjik, sipas përcaktimeve të akteve ligjore, nënligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme të EUROSIG.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë:



Vasil PILO
Kryetar



Rexhep MEIDANI
Anëtar



Skënder MADANI
Anëtar

Komiteti i Auditimit

Komiteti i Auditimit ndihmon Këshillin Mbikëqyrës në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse kundrejt aksionarëve dhe palëve të interesit; shqyrton dhe vlerëson rregullisht politikën, strategjitë, kufijtë dhe proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut në shoqërinë e sigurimit, si dhe jep rekomandime për Këshillin Mbikëqyrës në lidhje me miratimin e tyre, apo çdo ndryshim të tyre që gjykohet i përshtatshëm.

I krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 09.07.2015, Komiteti i Auditimit përbëhet nga:

Halim BAKALLI - Kryetar

Elda SHEHU - Anëtar

Adrian BATUSHA - Anëtar

Në ushtrimin e detyrave funksionale dhe përgjegjësi, Komiteti i Auditimit mbështetet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.



Menaxhimi i Lartë

Menaxhimi i Lartë mbikëqyr dhe përgjigjet për menaxhimin e veprimtarive dhe performancën e të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të EUROSIG.

Menaxhimi i Lartë përbëhet nga:



Xhevdet KOPANI
Drejtor i përgjithshëm



Venera XHILLARI
Drejtoresh e Departamentit të Marrjes në Sigurim, Risigurim dhe Marrëdhënieve me Jashtë



Anila IBRO
Drejtoresh e Departamentit Ekonomik dhe Operacional

Menaxhimi Operacional

Menaxhimi Operacional përbëhet nga drejtues të departamenteve, drejtorive, sektorëve, njësive të tjera strukturore qendrore dhe degëve vendore, menaxhon dhe përgjigjet për performancën e njësive strukturore të EUROSIG.



EUROSIG NËPËRMJET SHIFRAVE



Shoqëria EUROSIG për vitin 2015 ka performuar pozitivisht, duke treguar qëndrueshmëri, rritje dhe standarde të larta.

EUROSIG, për katër vitet e fundit, është klasifikuar si kompania me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve.

Disa tregues kryesorë të EUROSIG - Shqipëri për vitin 2015¹

Për vitin 2015, EUROSIG renditet në vendin e tretë në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, me 15,21% të tregut. Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG kapi shifrën e 1 985 090 000 lekë, duke shënuar një rritje me 47,24%, krahasuar me vitin 2014, ose 23,81% më shumë se mesatarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës. Numri i dëmeve të paguara nga EUROSIG ishte 2 286 ose 49,5% më shumë se në vitin 2014. Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG

¹ Sipas Buletinit Statistikor të AMF për Tregun e Sigurimeve, janar - dhjetor 2015.

ishte 645 495 000 lekë, duke u rritur me 398 597 000 lekë ose 161,44%, krahasuar me vitin 2014. Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG është 135,64% më shumë se mesatarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës. Vetëm për dëmin e shkaktuar në zonën Fier - Vlorë nga përmbytjet, në muajin shkurt 2015, EUROSIG pagoi shumën 2 milion euro. Vlera e sigurimeve të detyrueshme të EUROSIG është 1 265 293 000 lekë, kurse vlera e sigurimeve vullnetare 719 797 000 lekë. Peshë specifike e sigurimeve vullnetare të EUROSIG kundrejt totalit ishte 36,26%, ose 1,22% më shumë se mesatarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin Motorrik kapi shifrën 1 351 930 000 lekë, 292 994 000 lekë ose 27,67% më shumë se në vitin 2014. Pjesa e EUROSIG ndaj totalit në Sigurimin Motorrik është 14,93%, duke u renditur në vendin e tretë.

Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG për Sigurimin Motorrik është 249 181 000 lekë, 27 450 000 lekë ose 12,38 % më shumë se në vitin 2014.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin Motorrik (1 351 930 000 lekë) ndahet si në vijim: MTPL e Brendshme 839 785 000 lekë (62,12%), Kartoni Jeshil 351 575 000 lekë (26,01 %), Kufitare 73 933 000 lekë (5,47 %), Kasko 86 636 000 lekë (6,41%).



Pjesa e EUROSIG ndaj totalit është: MTPL e Brendshme 12,71%, duke u renditur në vendin e katërt; Kartoni Jeshil 28,12%, duke u renditur në vendin e parë; Kufitare 14,15%, duke u renditur në vendin e tretë; Kasko 15,01%, duke u renditur në vendin e tretë.

Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG për MTPL e Brendshme është 121 540 000 lekë, - 4 327 000 lekë ose 3,44% më pak se në vitin 2014.

Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG për Kartonin Jeshil është 79 513 000 lekë, 16 809 000 lekë ose 26,81% më shumë se në vitin 2014. Pjesa ndaj totalit e vlerës së dëmeve të paguara nga EUROSIG për MTPL e Brendshme është 18,67%, duke u renditur në vendin e dytë.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë² kapi shifrën 179 478 000 lekë, 90 921 000 lekë ose 102,67 % më shumë se në vitin 2014. Pjesa e EUROSIG ndaj totalit në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe

² Në klasën e sigurimit "dëmtime të tjera në pronë" është përfshirë sigurimi inxhinierik EAR, CAR.

Dëmtimet e tjera në Pronë është 9,38%, duke u renditur në vendin e pestë. Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG për Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë është

286 557 000 lekë, 284 457 000 lekë ose 13 547,87%, më shumë se në vitin 2014. Pjesa ndaj totalit e vlerës së dëmeve të paguara nga EUROSIG në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë është 43,47%, duke u renditur në vendin e parë.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit kapi shifrën 354 864 000 lekë, 205 877 000 lekë ose 138,18% më shumë se në vitin 2014. Pjesa e EUROSIG ndaj totalit në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 31,71%, duke u renditur në vendin e dytë.

Vlera e dëmeve të paguara nga EUROSIG për Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 108 911 000 lekë, 86 751 000 lekë ose 391,48% më shumë se në vitin 2014. Pjesa ndaj totalit e vlerës së dëmeve të paguara nga EUROSIG në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit është 23,35%, duke u renditur në vendin e dytë.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim kapi shifrën 45 784 000 lekë, 4,68% më pak se në vitin 2014. Pjesa e EUROSIG ndaj totalit në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim është 17,93%, duke u renditur në vendin e katërt.

Volumi i primeve të shkruara bruto nga EUROSIG në Sigurimin e Sëmundjeve kapi shifrën 184 795 000 lekë, 174 239 000 lekë ose 1 651% më shumë se në vitin 2014. Pjesa e EUROSIG ndaj totalit në Sigurimin e Sëmundjeve është 33,85%, duke u renditur në vendin e dytë.



Disa tregues kryesorë të kompanisë EUROSIG - Kosovë, për vitin 2015

Edhe kompania e Sigurimeve EURO-SIG, Kosovë, për vitin 2015-të, ka patur qëndrueshmëri dhe rritje të treguesve ekonomiko – financiar. Disa nga treguesit kryesor për vitin 2015, janë:

U realizua një volum i primeve të shkruara bruto, në shumën 11 215 608 Euro, ose 4,19 % më shumë se në vitin 2014. Rritja është më e lartë se rritja mesatare e tregut.

Vlera e dëmeve të paguara ishte 3 475 724 Euro, me një zbritje prej 20,45%, krahasuar me vitin 2014. Vlera e dëmeve të paguara zën 9,35% të vlerës së dëmeve në total, me një zbritje prej 4,59 %, krahasuar me vitin 2014.

Volumi i primeve të shkruara bruto në sigurime të detyrueshme u realizua në shumën 7 068 931 Euro, kurse në sigurime vullnetare 4 146 677 Euro. Raporti i volumit të primeve vullnetare ndaj volumit të primeve gjithsej është 36,97%, me një rritje ndaj peshës mesatare prej 4,62%.

Në totalin e volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm, EUROSIG zë 13,27% të tregut të sigurimeve, duke u renditur e para në treg. Në totalin e volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar, EUROSIG zë 16,29%, duke u renditur në vendin e tretë në treg.

Në volumin e primeve të shkruara bruto të sigurimeve motorrike EUROSIG zë 13,67% të tregut, nga 13,74% që zinte në vitin 2014.

Vlera e dëmeve në sigurimin motorrik është 2 371 101 Euro, me një zbritje prej 7,24%, krahasuar me vitin 2014.

Në sigurimin TPL, EUROSIG zë 13,39% të primeve të të gjithë tregut, duke u renditur në vendin e parë.



Blej sigurimin online!

www.eurosig-ks.com

Në sigurimin Kufitar, EUROSIG renditet në vendin e parë me 12,92% të tregut. Në sigurimin Kasko, EUROSIG renditet në vendin e dytë me 21,38% të tregut. Në sigurimin Shëndetësor, EUROSIG renditet në vendin e dytë me 23,06% të tregut.

Në vitin 2015 është lançuar aplikacioni i parë për sigurime në Kosovë i dedikuar për telefona të mençur. Është mundësuar për herë të parë në Kosovë blerja online e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim.

MOMENTE TË RËNDËSISHME



Në tërë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2015, shoqëria EUROSIG ka garantuar një shërbim të shpejtë dhe profesional ndaj klientëve, duke rritur shkallën e investimeve në modernizimin e veprimtarisë së kompanisë, sipas standardeve bashkëkohore.

Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës

Në kuadër të vlerësimeve dhe mbështetjeve reciproke, EUROSIG ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës. Qëllimi i këtij memorandumi është vendosja e raporteve të bashkëpunimit midis EUROSIG dhe Universitetit të Tiranës, në organizimin e punimeve studimore për sektorët që përfaqësohen nga këto organizata.

Bashkëpunimi midis dy institucioneve konsiston në:

Financimin e mundësive për zhvillim të studentëve më të mirë të UT, kërkuesve dhe stafit, në konferenca ndërkombëtare.

Organizimin e tryezave pune të përbashkëta me objektiv ballafaqimin e problemeve që shqetësojnë këto

grupime, si dhe promovimin e arritjeve në këta sektorë.

Organizimin e praktikave mësimore, studimeve dhe kërkimeve shkencore, stazh pune etj., pranë strukturave qendrore dhe vendore të EUROSIG.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, për të tretin vit radhazi, Presidenti i EUROSIG, z. Kadri Morinaj, akordon 4 bursa studimi për studentët më të mirë në Studime Master, sikundër mundëson edhe 20 studentë që të kryejnë praktikën mësimore pranë EUROSIG.

EUROSIG blen shoqërinë DARDANIA

Pas negociatash të frytshme 2 vjeçare EUROSIG SHA kurorëzoi blerjen e 100% të aksioneve të Kompanisë së Sigurimeve DARDANIA SHA, e cila mban vendin e dytë në tregun e sigurimeve në Kosovë.

Ky investim ambicioz dhe afatgjatë, përveç perspektivës së sigurtë drejt së ardhmes së veprimtarisë së biznesit, premtan mbi të gjitha zhvillim të mëtejshëm të shërbimeve të sigurimit përmes shkëmbimit të eksperiencave më të mira mes dy kompanive në Shqipëri dhe Kosovë, të krahasueshme me vendet e rajonit dhe ato Europiane.



EUROSIG – kompania më e mirë e vitit 2015

Një nga momentet më të rëndësishme, gjatë vitit 2015, ishte vlerësimi i arritjeve të Shoqërisë EUROSIG nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë duke i akorduar çmimin si "Sipërmarrje e suksesshme".

Gjatë ceremonisë zyrtare të dhënies së çmimit më datën 13 dhjetor 2015, EUROSIG u cilësua si:

Kompania me rritjen më të madhe në industrinë e sigurimeve, për të tretin vit radhazi.

Kompania me ritmet më të larta të pagesave të dëmeve.

Kompani me shtim të investimeve, duke zgjeruar aktivitetin e saj në Republikën e Kosovës.

Analiza pune

Në qershor 2015, në bregdetin e mrekullueshëm Jonian, Dhërmi, u zhvillua analiza pesë mujore e punës e shoqërive EUROSIG - Shqipëri dhe EUROSIG - Kosovë. Analiza e punës vjetore dhe treguesve financiar të Shoqërisë EUROSIG, për vitin 2015, u bë më 28 janar 2016, në Hotel

"Sheraton", Tiranë. Në këtë takim, krahas evidentimit të sukseseve dhe arritjeve pati dhe qëndrime kritike nga Presidenti, Këshilli Mbikëqyrës dhe Menaxhimi i Lartë për probleme të konstatuara gjatë vitit 2015. Më pas u miratuan objektivat strategjike dhe specifike të EUROSIG për vitin 2016.



NE JEMI EUROSIG



Shoqëria Aksionare EUROSIG është themeluar, më 16. 07. 2004, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më 19. 07. 2004, me NUIS K41926801W. Drejtoria e Përgjithshme (struktura qendrore) e shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me ligjin nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe aktet tjetër nënligjore dhe rregullatore të dala në zbatim të tij, si dhe mbikëqyrret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Gjithashtu, udhëhiqet nga Statuti i Shoqërisë dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Shoqërisë EUROSIG SHA dhe një tërësi aktesh të brendshme.

EUROSIG, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë me 22 degë dhe mbi 230 agjenci dhe pika shitjeje e përfaqësimi. Në Drejtorinë e Përgjithshme ushtrojnë veprimtarinë Departamenti i Marrjes në Sigurim, Risigurim dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Departamenti Ekonomik dhe

Operacional, Departamenti i Dëmeve, Drejtoria e Marrjes në Sigurim, Drejtoria e Shitjes dhe Sigurimeve Motorrike, Drejtoria e Financë-Kontabilitetit & Analizës, Drejtoria Juridike, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Njësia e Administrimit të Riskut, sektorët për produktet e sigurimit të Shëndetit, të Pasurisë, Kasko etj. Aktivitetet kryesore të EUROSIG përfshijnë:

Produktet e sigurimeve vullnetare:

- Sigurimi i Aksidenteve Personale,
- Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve,
- Sigurimi Kasko,
- Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës),
- Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë,
- Garancitë,
- Sigurimi i Mallrave në Transport,
- Sigurimi i Përgjegjësisë të Anijeve dhe Mjeteve Lundruese,
- Sigurimi i Përgjegjësisë të Përgjithshme (të të gjitha llojeve),
- Sigurimi i Bankave BBB & ECC;



Produktet e sigurimit të detyrueshëm:

Sigurimi i Detyrueshëm Motorrik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMTPL),

Certifikata Motorrike Ndërkombëtare e Sigurimit - Kartoni Jeshil, Sigurimet Kufitare.

Zgjerimi i rrjetit të shitjes, pozicionimi në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme dhe relativisht të shpejtë, ka ardhur si rezultat i një pune të vazhdueshme dhe i një stafi të kualifikuar, dinamik dhe profesionist të vërtetë në fushat që veprojnë. Drejtuesit dhe

punonjësit e EUROSIG janë të vëmendshëm ndaj kërkesave të klientit, duke ju ofruar atyre produktet më favorite dhe këshillat më të mira.

EUROSIG, për katër vitet e fundit, është klasifikuar si kompania me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve. Aktualisht, për veprimtarinë e sigurimit të Jojetës EUROSIG renditet e dyta, me 16,52% të tregut. EUROSIG ka rentabilitet shumë të mirë.



SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

DEGËT E EUROSIG

Drejtoria e Përgjithshme

Rr. "Papa Gjon Pali II", Vila nr. 5,
Tiranë, Shqipëri

Kontakte në Drejtorinë e Përgjithshme

Drejtori i Përgjithshëm
Xhevdet KOPANI
xhkopani@eurosig.al
Mob: +355 69 40 00 412

Departamenti i Marrjes në Sigurim, Risigurim & Marrëdhënieve me Jashtë

Venera XHILLARI/BICA
Drejtor
venera.xhillari@eurosig.al
Mob: +355 69 20 79 701

Departamenti Ekonomik dhe Operacional

Anila IBRO
Drejtor
anibra@eurosig.al
Mob: +355 69 20 58 675

Departamenti i Dëmeve

Musa HUTI
Drejtor
mhuti@eurosig.al
Mob: +355 66 59 20 221

Drejtoria e Financës

Elda Shehu
Drejtor
eshehu@eurosig.al
Mob: +355 66 20 45 889

Drejtoria e Shitjeve & Sigurimeve Motorike

Edmond Palushaj
Drejtor
Mob: +355 67 40 24 727
epalushaj@eurosig.al

Drejtoria Juridike

Krizelda Thartori/Çela
Drejtor
kthartori@eurosig.al
Mob: +355 66 40 95 541

Sektori i Teknologjisë së Informacionit

Fatjon Saja
Shef
fsaja@eurosig.al
Mob: +355 66 40 95 540

Njësia e Administrimit të Riskut

Veli Haklaj
Shef
vhaklaj@eurosig.al
Mob: +355 69 85 38 593

Aktuaristika

Areta Çuko
acuko@eurosig.al
Mob: +355 67 22 99 970

Sekretaria info@eurosig.al

+355 (0) 42 238 999 / 899
+355 (0) 66 20 70 659
+355 (0) 42 223 841

Dega Tirana 1

Drejtor: Arben Hajdarmataj
Bulevardi "Bajram Curri", për-
ballë Eksp. "Shqipëria Sot"
ahajdarmataj@eurosig.al
+355 (0) 42 272 - 944

Dega Tirana 2 (Kamëz)

Drejtor: Vladimir Qilimi
Bulevardi "Blu", Kamëz
dega.kamëz@eurosig.al
+355 (0) 66 20 70 672

Dega Tirana 3

Drejtor: Sokol Gashi
Rr. e "Durrësit", përballë
bllokut të ambasadave
sgashi@eurosig.al

Dega Tirana 4

Drejtor: Edison Çollaku
Rr. "Asim Vokshi", përballë
shk. "Harry Fultz"
dega.tirane4@eurosig.al

Dega e Tropojës

Përfaqësues: Gazmend Doçi
Rr. "Azem Hajdari"
dega.tropoje@eurosig.al
+355 (0) 21 32 30 55

Dega e Shkodrës

Drejtor: Siruan Lishi
Rr. "2 Prilli", pranë Poliklinikës
Qendrore
dega.shkoder@eurosig.al
+355 (0) 22 44 592

Dega e Lezhës

Përgjegjës: Marie Ndoj
Lagjia Beslidhja, P. 63
dega.lezhe@eurosig.al

Dega e Laçit

Laç, qendër
dega.lac@eurosig.al

Dega e Kukësit & Hasit

Drejtor: Shkëlzen Malaj
Krumë, qendër
dega.kukes@eurosig.al
+355 (0) 21 42 21 42

Dega e Dibrës (Peshkopisë)

Drejtor: Asqeri Pepa
Sheshi "Bajram Curri"
dega.peshkopi@eurosig.al
+355 (0) 21 82 550

Dega e Burrelit

Përfaqësues: Shpetim Çupi
Sheshi "Ahmet Zogu", pranë
Alpha Bank
dega.mat@eurosig.al

Dega e Elbasanit

Drejtor: Adil Kabila
Përballë Postës Qendrore
dega.elbasan@eurosig.al
+355 (0) 66 20 70 328

Dega e Durrësit

Drejtor: Enkelejda Çopa
Rr. "Admiral Abdi Mati", për-
ballë Tatim -Taksave
dega.durres@eurosig.al
+355 (0) 52 23 41 36

Dega e Korçës

Drejtor: Zana Mançe
Bulevardi "Gjergj Kastrioti"
dega.korce@eurosig.al
+355 (0) 82 24 80 62

Dega e Pogradecit

Drejtor: Elona Katiraj
Lagj. 2, Rr. "Reshit Çollaku"
dega.pogradec@eurosig.al
+355 (0) 83 22 30 07

Dega e Bilishtit

Përfaqësues: Aurel Frashëri
Bilisht, qendër
dega.bilisht@eurosig.al

Dega e Fierit

Drejtor: Rustem Hoxha
Bulev. "Jakov Xoxa", pranë
Nino Vital
dega.fier@eurosig.al
+355 (0) 34 22 91 93

Dega e Lushnjës

Drejtor: Albert Çela
Bulevardi kryesor, pranë
BKT-së
dega.lushnje@eurosig.al
+355 (0) 35 22 57 34

Dega e Beratit

Drejtor: Bexhet Alia
Lagjia "30 Vjetori", pranë far-
macisë "Klodi", Berat
dega.berat@eurosig.al
+355 (0) 32 23 76 22

Dega e Vlorës

Drejtor: Fatmir Hyseni
Lagjia "Pavarësia"
dega.vlore@eurosig.al
+355 (0) 33 40 05 30

Dega e Gjirokastrës

Drejtor: Zenel Peta
Ish-blloku i furrave
dega.gjirokaster@eurosig.al
+355 (0) 84 26 85 50

Dega e Sarandës

Përgjegjës: Thanas Qirjaqi
Rr. e "Flamurit"
dega.sarande@eurosig.al
+355 (0) 85 22 29 59

Klientët e EUROSIG

Klientët tanë vijnë nga fusha të ndryshme të industrisë dhe rajone në të gjithë Shqipërinë, përfshirë dhe klientë ndërkombëtarë.

Ne jemi të fokusuar në klientelën e produkteve TPL dhe Kasko, me agjentë të përzgjedhur, dhe kërkojmë cilësi në ofrimin e shërbimit prej tyre, duke demonstruar aftësinë për të tërhequr klientelë të re dhe duke menaxhuar risqet në këtë nivel. Jemi në zgjerim në produktet e Sigurimit Vullnetar të Shëndetit, Sigurimit Kasko dhe Kartonit Jeshil. Klientela e bizneseve të vogla identifikohet nga ndërmjetësit dhe agjentët e besueshëm. Risqet më të mëdha përzgjidhen nga ndëreveprimi i ndërmjetësve dhe specialistëve të marrjes në sigurim të EUROSIG.

Kënaqësia për shërbimet e sigurimit që ofrojmë ka sjellë rritjen e vazhdueshme të numrit të klientve të EUROSIG.

Partnerët e EUROSIG

Kompanitë e risigurimit - Garanci financiare dhe mbrojtje për klientin

Detyrimet financiare ndaj klientëve garantohen jo vetëm nga kapacitetet tona teknike dhe financiare, por dhe nga tregu financiar ndërkombëtar. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit që lidh EUROSIG janë shoqëri risigurimi që përmbushin nivelet ndërkombëtare të pagesës së dëmeve, të listuara në bazën e vlerësimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.52, datë 22.05.2014, "Për

veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", aktet nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG.

Shoqëria EUROSIG ka investuar një kosto relativisht të lartë për risigurimet (rreth 7% ndaj totalit të të ardhurave), me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Trust Re, Generali Italia SPA, Partner Re, Scor Re, për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme ndaj klientëve, si në risqet e sigurimit të pronës ashtu dhe në ato të sigurimeve motorrike dhe të përgjegjësiive. Grupi EUROSIG ka edhe risigruues të tjerë me të cilët bashkëpunon, si Munich Re, Transatlantic Re, Atradius Re. Ne gjithashtu zhvillojmë marrëdhënie bashkëpunimi për risqet fakultative edhe me kompani të tjera risigruuese, gjithnjë duke u mbështetur në kriterin e vlerësimit financiar si dhe standardin e bashkëpunimit.

Marrëveshjet e Risigurimit të Pronës dhe Sigurimit të Detyrueshëm për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta, përveç garancisë financiare në pagesat e dëmeve të mëdha, kanë krijuar një fleksibilitet dhe cilësi të veçantë shërbimi ndaj klientëve.

Shoqëria EUROSIG ka bashkëpunim edhe me broker risigurimesh, me të vetmin qëllim: aranzhimin e kushteve teknike sa më adekuate dhe profesionale. Brokerët e risigurimit që ne bashkëpunojmë janë: Aon Benfield (brokeri më i madh në botë), JLT Re brokeri i katërt në botë, MAI broker.



Vlerësime për partnerët e EUROSIG

Hannover Re

Agjencitë e vlerësimit më të rëndësishme në industrinë e sigurimeve i kanë dhënë kompanisë së sigurimeve Hannover Re vlerësime shumë të forta për fuqinë financiare. Hannover Re, me një volum primesh bruto prej rreth 12 miliardë euro, është kompania e tretë risigruuese më e madhe në botë. Kjo kompani kryen aktivitet në të gjitha linjat e Risigurimit të Jo-Jetës, Jetës dhe Shëndetit, duke qenë e pranishme në të gjitha kontinentet.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
A.M. Best	A+	Superior
S&P	AA-	Very strong

Polish Re

Shoqëria e Risigurimit Polish Re (Polskie Towarzystwo Reasekuracji) është e vetmja kompani në Poloni e specializuar në mënyrë rigoroze në biznesin e Risigurimit, në ofrimin e sigurimit të kompanive të sigurimit duke marrë përsipër pjesën e të ardhurave të tyre, primet e sigurimit në këmbim për pjesëmarrjen e mëvonshme në mbulimin e humbjeve. Kjo kompani ka hyrë në tregun e Risigurimit që nga qershori 1996. Kompania operon në 40 vende, me mbi 200 klientë. Polish Re është një risigruues lider dhe ka fituar besimin e klientëve në të gjitha shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Vlerësimi:

Rating Agency	Rating	Outlook
S&P	BBB+	Positive outlook
A.M. Best	A-	Stable

Generali Italia SPA

Grupi "Generali Italia SPA" është një nga lojtarët më të rëndësishëm në tregun e sigurimit global dhe financiar, e themeluar që në vitin 1831, në Trieste. Karakterizohet që nga fillimi me një opinion të fortë ndërkombëtar dhe tani është e pranishme në më shumë se 60 vende të botës. "Generali Italia SPA" ka konsoliduar pozicionin e tij në mesin e botës së operatorëve kryesor të sigurimit, me aksione të ndjeshme në treg në Evropën Perëndimore - zona e saj kryesore e veprimtarisë - dhe veçanërisht në Gjermani, Francë, Austri, Spanjë dhe Zvicër. Ai gjithashtu mban një pozitë të fortë në treg në Argjentinë. Ka mbi 500 kompani ndërkombëtare. Fitch e ka klasifikuar "Generali Italia SPA" me A- dhe Stable, kurse A.M. Best me A.

Vlerësimi i shoqërive të tjera risigruuese

REINSURANCE	RATE	
	S&P	A.M. BEST
PARTNER REINSURANCE COMPANY, SWITZERLAND	A+	A+
SCOR GLOBAL P&C DEUTSCHLAND	A+	A-
TRUST RE	A-	A-
SWISS RE	AA-	A+
VIG RE, CZECH REOUBLIC	A+	
SAVA RE, SLOVENIA		A-



PËRGJEGJËSIA SOCIALE



EUROSIG i ka kushtuar përgjegjësisë sociale një vëmendje shumë të madhe. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, Z. Kadri MORINAJ, EUROSIG ka angazhuar burime njerëzore dhe shpenzuar shuma të konsiderueshme, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejtë të shoqërisë dhe mejdisit ku EUROSIG ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mejdisit kulturor, artistik, mediatik etj. Gjatë vitit 2015, EUROSIG ka mbështetur financiarisht veprimtari të shumtasi ekspozita, botime librash, koncerte muzikore, vepra teatrore, aktivitete sportive, të cilat bëjnë të mundur pikërisht atë mbështetje, atë plotësim të atij dimensionit që biznese të mesme dhe të mëdha janë duke luajtur në drejtim të zhvillimit të artit, kulturës dhe sportit duke treguar që më mirë sesa strukturat shtetërore dhe vendimmarrjet burokratike shtetërore, sipërmarrje si EUROSIG mund të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në këtë drejtim.

Disa veprimtari të mbështetura financiarisht nga EUROSIG gjatë vitit 2015:

- Presidenti i EUROSIG, Z. Kadri MORINAJ, është një ndër themeluesit e çmimit prestigjioz "Pjetër Bogdani".
- Maj 2015: EUROSIG, si një nga sponsorët e festivalit në RTSH (2014), mbështeti këngëtarene Elhaida Dani, përfaqësuese e Shqipërisë në Eurovizion.
- Mars 2015: Në Festivalin e Filmit në Pogradec, More Raça, regjisorja e filmit "Amel", mori çmimin special mundësuar nga EUROSIG.
- Prill 2015: Me nismë të Presidentit të saj z. Kadri Morinaj, EUROSIG u ka akorduar bursa studimi tre prej studentëve të ekselencës, në Fakultetin Ekonomik të Tiranës.
- Maj 2015: EUROSIG mbështeti financiarisht evenimentin "Albania Open", ku qielli i qytetit bregdetar të Vlorës u ngjyros nga dhjetëra parashutistë nga e gjithë Europa. Ky eveniment shërbeu edhe si një promovim i vlerave turistike të vendit tonë.
- Maj 2015: EUROSIG mbështeti financiarisht Auto Moto Show-Tirana në edicionin e tij të dytë, në Tirana Expo Centre.



- Qershor 2015: EUROSIG, një nga mbështetësit më të mëdhenj të artit dhe traditës shqiptare, sponsorizoi gjysmëfinalen dhe finalen e Festivalit të Talenteve të Rinj, një festival në interpretim shqip me pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Mali i Zi.
- Gusht 2015: EUROSIG dhe z. Kadri Morinaj mbështesin promovimin e vlerave dhe traditave shqiptare edhe në festën tradicionale të Bytyçit, festën e "Plisit të Bardhë".
- Gusht 2015: EUROSIG mbështet Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit për kalendarin artistik shtator – dhjetor 2015.
- Shtator 2015: EUROSIG dhe z. Kadri Morinaj sponsor gjeneral i emisionit Ora Skaner të gazetarit Gerti Çarçani, në RTV Ora News.
- Shtator 2015: Z. Kadri Morinaj, biznesmeni me mendje të hapur dhe zemër bujare mbështet veprimtaritë e Kryegjyshit Botërore të Bektashinjve, në Tiranë.
- Shtator 2015: EUROSIG dhe z. Kadri Morinaj, qëndrojnë më afër artit e kulturës, më afër artistëve, që përcjellin art dhe emocion për qytetarët. Mbështetje financiare, për organizimin e ekspozitës "Art&Wine" të piktorëve shqiptarë, z. Muhamet Kërpaçi dhe z. Leonardo Voci.
- Tetor 2015: EUROSIG mbështet Institutin e Librit dhe të Promocionit, në Tiranë. Bashkëpunim midis palëve për organizimin e veprimtarive të Kolonisë së Piktorëve të Peizazhit nga Shqipëria dhe Kosova, në Kukës, Prizren dhe rrethinat e tyre.

- Dhjetor 2015: Lule dhe falënderime për z. Kadri Morinaj. Fiorentina Brija sjell lule dhe mirënjohje për atë që e ndihmoi të ecë, për atë që merr përsipër të ndihmojë Fiorentinën, e cila fatkeqësisht lindi me një gjymtyrë të poshtme.
- Tetor 2015: EUROSIG mbështet këngëtarin e mirënjohur Kozma Dushi, në krijimtarinë e tij artistike.
- Dhjetor 2015: EUROSIG mbështet botimin e librit "Histori Diplomatike dhe Kujtime për Gjermaninë" të diplomatit të karrierës Bashkim Zeneli.
- Dhjetor 2015: EUROSIG mbështet kompozitorin Aleksandër Lalo në "Koncert në prag të Krishtlindjes", ekzekutuar nga Kuinteti i Harqeve.
- Dhjetor 2015: EUROSIG dhe z. Kadri Morinaj, si gjithmonë, në ndihmë të fëmijëve në nevojë, pa përkrahje, pa të ardhura dhe në shpresë për një të ardhme më të mirë.
- Dhjetor 2015: Presidenti i EUROSIG, z. Kadri Morinaj, në prani të poetit Agim Doçi dhe kompozitorit Edmond Zhulali u jep çmimin e EUROSIG këngëtarëve të talentuar Rezarta Smaja dhe Klodjan Kaçani për paraqitjen e tyre në Festivalin e 54-t të RTSH.
- Dhjetor 2015: Mbrëmja e Krishtëlindjeve dhe Vitit të Ri në EUROSIG: arritje, suksese, argëtim, muzikë, art, çmime, promovime, mështetje financiare për udhëtime turistike dhe të tjera surpriza.

Edhe EUROSIG - Kosova, në kuadër të përgjegjësisë sociale, ka mbështetur financiarisht aktivitete kulturore, artistike dhe sportive. Evidentojmë mbështetjen e ekipit të basketbollit "KB Peja", i cili në Kosovë ka qenë nënkampion dhe është paraqitur me shumë sukses edhe në arenën ndërkombëtare.



MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG



Në zbatim të detyrimeve të akteve ligjore, nënligjore, rregullatore dhe akteve të brendshme, EUROSIG është angazhuar për të implementuar një sistem të plotë të menaxhimit të riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet e shoqërisë, në mënyrë që të mbështesin realizimin e objektivave strategjike dhe specifike.

Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të EUROSIG, në tërësi dhe në drejtim të pranimi dhe administrimit të riskut, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm kanë nxjerë një sërë aktesh të brendshme, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 52, datë 22.05.2015, si dhe aktet e tjera nënligjore dhe rregullatore.

Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës, Menaxhimi i Lartë, Menaxhimi Operacional dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij në aktet e brendshme të EUROSIG, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij. Kjo siguron dhe lidhjen e nevojshme midis detyrave që ka çdo punonjës dhe mënyrës se si i kryejnë këto detyra.

Duke marrë në konsideratë madhësinë e veprimtarisë së shoqërisë, kompleksitetin e saj dhe

profilin e riskut, EUROSIG ka krijuar Njësine e Administrimit të Riskut, punonjësit e së cilës janë trajnuar nga AMF. Kjo Njësi ka autoritet të plotë për marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për ushtrimin e detyrave funksionale të përcaktuara në aktet rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG.

Gjithashtu, Njësia e Administrimit të Riskut në EUROSIG, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre; vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut; vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës. Mbështetur në Strategjinë pesëvjeçare të EUROSIG, është miratuar Strategjia për Menaxhimin e Riskut, në të cilën janë përcaktuar: sistemi, politika, dhe parimet e menaxhimit të riskut; procesi i menaxhimit të riskut (vendosja e objektivave, kategoritë e riskut, oreksi i riskut, tolerancat e riskut, identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, trajtimi i riskut, monitorimi i menaxhimit të riskut); përgjegjësitë për menaxhimin e riskut; strategjitë e menaxhimit të riskut dhe dokumentimi dhe raportimi i çdo faze dhe veprimi të procesit të menaxhimit të riskut.



Në zbatim të përcaktimeve në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të EUROSIG, në Strategjinë për Menaxhimin e Riskut është përcaktuar edhe metodologjia për identifikimin, klasifikimin (kategorizimin), vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve. Për këtë, EUROSIG aplikon qasjen e AMF, të përcaktuar në manualin nr. 132, datë 31.10.2014, "Mbikëqyrja me fokus riskun".

Njësia për Administrimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore të EUROSIG, identifikojnë risqet ndaj të cilave është e ekspozuar vep-
rimtaria e EUROSIG dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të shoqërisë. Këto risqe klasifikohen në shtatë katego-
ritë kryesore, si më poshtë:

1. Risku i Kreditit,
2. Risku i Tregut,
 - Risku i Normës së Interesit,
 - Risku i Këmbimit të Monedhës së Huaj,
3. Risku i Sigurimit,
 - Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit,
 - Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësi,
4. Risku Operacional,
5. Risku i Likuiditetit,
6. Risku Ligjor dhe Rregullator,
7. Risku Strategjik.

Bazuar dhe në vlerësime sasisore, sipas linjave të biznesit, në përfundim të pro-
cesit, bëhet një vlerësim cilësor i risqeve, duke i kategorizuar si i ulët, Mesatar ose i lartë.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Euros sig finalizohet me Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pague-
se. Për hartimin e këtij Raporti përdoren teknikat analitike: analiza PESTEL, analiza SWOT, analiza e linjave të biznesit, analiza krahasuese e të dhënave, analiza e riskut etj. Versioni i plotë i Raportit u vihet në dispozicion Presidentit, Këshillit Mbikëqyrës, Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Lartë të EUROSIG, kurse versioni i redaktuar u vihet në dispozicion Menaxhimit Operacional të EUROSIG. Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës miraton Plan-
veprimin për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pague-
se.



PJESËMARRJET E EUROSIG NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA

EUROSIG është pronare e Kompanisë së Sigurimeve EUROSIG-Kosovë, me 100% të kapitalit.

Gjithashtu, aksionarët e EUROSIG janë pjesëmarrës në kapitalin e shoqërive të tjera, si më poshtë:

Nr.	Aksionarët	Shoqëria	%
1.	"Euro-Alba Ea" sh.p.k	"Plus Communication" sh.a.	2,04%
2.	Kadri Morinaj	Bar Restaurant "Piazza" sh.p.k.	100%
3.	Xhevdet Morina	"Alb Univers" sh.p.k.	100%

LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT

Nr.	Aksionar influencues për vitin 2015	%
1.	Kadri Morinaj	62,861%
2.	"Euro Alba E.A" Sh.p.k.	32,698 %

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM



Auditimi i brendshëm për vitin 2015 në EUROSIG është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm; si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"; rregullores nr.153, datë 23.12.2014, "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit"; rregullores nr. 7, datë 30.01.2015, "Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sha" dhe Planit vjetor e programeve operative të auditimit të brendshëm të shoqërisë.

Gjatë vitit 2015, për realizimin e auditimeve janë angazhuar dy punonjës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, z. Vehbi SPAHIU (Kontabilist i Miratuar/ Audit i Brendshëm Publik) dhe znj. Aurela SHPATA (Msc. Kontabilitet – Auditim). Gjatë vitit 2015, punonjësit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm kanë kryer trajnime lidhur me "Identifikimin dhe menaxhimin e riskut". Buxheti që i është vënë në dispozicion Njesisë ka mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe ka qenë i mjaftueshëm për realizimin e veprimtarisë së saj. Gjatë kryerjes së auditimeve nuk ka pasur asnjë rast të cenimit të pavarësisë së audituesve.

Në përputhje me synimet e përcaktuara të auditimit, për:

- dhënien e një sigurie të arsyeshme menaxhimit të shoqërisë EUROSIG, për përmirësimin e veprimtarisë së saj dhe frytshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - përdorimin me efektivitet të burimeve njerëzore e financiare;
 - mbështetjen ligjore të veprimtarisë në të gjithë zinxhirin administrativ dhe operacional;
 - mirëadministrimin e vlerave materiale e monetare;
- si dhe në zbatim të Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2015, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vendosur si objektiva kryesore:
- mbikëqyrjen e realizimit të treguesve kryesorë dhe analizën e tyre,
 - mirëadministrimin e burimeve financiare të shoqërisë,
 - realizimin e detyrave dhe të drejtave të personelit,
 - sistemin e evidentimit dhe raportimit të të dhënave nga njësitë vartëse.

Rekomandimet e lëna gjatë auditimit janë pranuar në masën 100% nga Këshilli Mbikëqyrës i EUROSIG dhe janë zbatuar apo janë në proces zbatimi nga strukturat përgjegjëse. Në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit 2015, janë kryer auditime përputhshmërie, për të cilat fushat dhe objektet e auditimit janë si më poshtë:



Fushat me risk të lartë

- Rastet e sigurimit të objekteve në vlera të mëdha dhe risqe të larta. Procedura e marrjes në sigurim dhe zbatimi i kushteve të kontratës.
- Shpenzimet e marrjes në sigurim, efektiviteti i tyre, zbatimi i urdhrave dhe kriterëve për përcaktimin e masës së këtyre shpenzimeve.
- Rakordimi i të dhënave kontabël dhe primeve të arkëtuara me të dhënat nga rregjistrimi i policave të shitura.
- Administrimi i aseteve të shoqërisë në Drejtorinë Qendrore dhe në degët rajonale.
- Transaksionet financiare. Ligjshmëria dhe saktësia e dokumenteve të transaksioneve.
- Çështjet gjyqësore. Masat e marra për parandalimin e padive gjyqësore, përfaqësimi në gjykatë.

Fushat me risk të mesëm dhe të ulët

- Zbatueshmëria e ligjit dhe rregulloreve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Zbatueshmëria e akteve të brendshme të EUROSIG (statutit, vendimeve, rregulloreve, udhëzimeve, urdhrave, procedurave standarde).
- Efektiviteti i punës së degëve dhe departamenteve përkatëse për realizimin e shitjeve.
- Organizimi dhe realizimi i detyrave në rrjetin e shitjes.
- Kontrolli dhe analiza e shpenzimeve administrative.
- Kontrolli i shpenzimeve për përballimin e dëmeve, përlllogaritja e tyre dhe zbatimi i kriterëve ligjore dhe nënligjore.
- Analiza e debi - kredive; puna që bëhet për evidentimin e saktë dhe uljen e

detyrimeve debitore, ndjekjen e padive të regresit, zbatimin e vendimeve gjyqësore.

- Mbajtja e kontabilitetit; zbatimi i rregullave për mbajtjen e evidencës kontabël, raportimet statistikore dhe kontabël të treguesve financiarë.
- Administrimi i policave të sigurimit dhe vlerave materiale e monetare në qendër, degë dhe agjenci; zbatimi i procedurave për ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, hartimi i dokumenteve përkatës dhe zbatimi i kriterëve ligjore.

Gjetjet e auditimit

Administrimi i vlerave materiale dhe monetare

- Vlerat materiale, përfshirë inventarin e imët, kancelaritë, paisjet e zyrave, materialet e konsumit, policat e sigurimit etj., dokumentohen nëpërmjet fletë-hyrjeve të magazinës.
- Lëvizja dhe konsumi i tyre bëhet mbi bazë të nevojave, kërkesave dhe normave të konsumit. Dalja e tyre bëhet e autorizuar dhe e dokumentuar.
- Kontabilizimi i blerjeve, hyrjeve-daljeve dhe konsumit të tyre është korrekt.
- Shpërndarja e policave bëhet mbi bazën e kërkesës së degëve/agjentëve, duke marr në konsideratë nevojën, shitjen dhe gjendjen aktuale të policave të sigurimit në degë/agjent.
- Shpërndarja e policave degë-agjent jo gjithmonë bëhet duke u shoqëruar me dokumentacion të rregullt që vërteton përgjegjësinë materiale.
- Inventarizimi periodik dhe vjetor, rakordimi me evidencën kontabël dhe sistemin e diferencave bëhet në bazë të rregullave e kriterëve të përcaktuar në ligjin për kontabilitetin dhe aktet e tjera nënligjore.



Pasqyrimi i shitjeve në sistemin e brendshëm të kompanisë

- Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktësisht në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
- Për shkak të problemeve të sistemit të Brokerit, ekzistojnë diferenca jo të konsiderueshme mes shitjeve të kompanisë dhe atyre të pasqyruara në Broker për produktet motorrike të detyrueshme.

Efikasiteti i përdorimit të fondeve dhe risqet potenciale përkatëse

- Procesi i blerjeve realizohet pas hartimit të kërkesave dhe shqyrtimit të nevojave të paraqitura nga drejtoritë dhe degët.
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave bëhet nga titullari i kompanisë me qëllim eliminimin e blerjeve të panevojshme dhe krijimin e stoqeve apo shpenzimeve jo efikase.
- Blerjet realizohen mbi bazën e urdhërit të personave përgjegjës dhe kriterëve të përcaktuara nga menaxhimi.
- Pagesat për blerjet e kryera janë pasqyruar në kontabilitet sipas vlerave të faturave të blerjes.

Aplikimi i normativave të konsumit

- Në kompani ka normativa të vendosura dhe që aplikohen për harxhimin e karburantit, gomave etj.
- Shpenzimet e karburantit janë të dokumentuara nëpërmjet kuponit tatimor dhe janë brenda normave të lejuara të shpenzimeve për karburant.
- Lëvizja e automjeteve bëhet për qëllime pune, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në aktet e brendshme të EUROSIG.

Sistemi i kontrollit të brendshëm për debi-kreditë

- Evidenca kontabël lidhur me debitorët dhe kreditorët është pasqyruar saktësisht.
- Llogaritë sintetike rakordojnë me ato analitike.
- Lista e debitorëve ndiqet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhimi.
- Njohja e humbjeve nga Llogaritë e Arkëtueshme bëhet sipas standardeve përkatëse.

Sistemi i kontabilitetit dhe evidenca kontabël

- Evidenca kontabël lidhur me veprimet bankare dhe veprimet e arkës është pasqyruar saktësisht dhe kronologjikisht në sistemin financiar.
- Çdo veprim është azhurnuar në llogaritë analitike.
- Kontabilizimet në librin e madh janë kryer saktësisht.
- Llogaritë analitike rakordojnë me ato sintetike.

Përfundime

Shoqëria EUROSIG:

- Ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mban në mënyrë të rregullt, të saktë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit evidencën kontabël të veprimtarisë ekonomiko-financiare.
- Pasqyron në evidencën kontabël në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe në përputhje me Standardet të dhënat për transaksionet e kryera.
- Përpunon saktë të dhënat financiare, teknike dhe statistikore sipas përkatësive dhe detyrave të ngarkuara.
- Zbaton me seriozitet masat e vendosura dhe të ndërmarra nga organet mbikëqyrëse të shoqërisë dhe ato eprore.
- Përgatit rregullisht raporte financiare e statistikore periodike e vjetore.
- Njeh, parashikon dhe zbaton rregullat e menaxhimit të riskut.

Rekomandime

- Forcimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.
- Rritja e bashkëpunimit mes strukturave të kompanisë në mënyrë që çdo problematikë e konstatuar të zgjidhet në kohën e duhur.
- Procedura e kthimit, dëmtimit, anulimit të policave të shoqërohet me dokumentacionin përkatës.
- Shpërndarja e policave të shoqërohet gjithmonë me fletë-dalje.
- Humbja e policave të raportohet në momentin e konstatimit dhe të bëhet deklarimi i humbjeve dhe sistemimi i diferencave sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.
- Shpenzimet e komisioneve të përcaktohen nga instancat përkatëse dhe i gjithë procesi i deklarimit dhe miratimit të komisioneve të dokumentohet.
- Të kryhen trajnime të vazhdueshme për punonjësit lidhur me njohjen e rregullave, produkteve etj.
- Të krijohet një procedure pune për krahasimin e shitjeve të pasqyruara në Broker dhe atyre të pasqyruara në sistemin e brendshëm të kompanisë, me qëllim eliminimin e diferencave Broker - Sistem.



OBJEKTIVAT PËR VITIN 2016



Objektivat strategjike

- Rritja me 20%, krahasuar me vitin e mëparshëm, e primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike, të aftësisë paguese, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- Në fundin e vitit 2016, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm motorrik me volumin e primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar të jetë në masën 60 me 40.
- Shpenzimet për vitin 2016 të mbahen në nivelin 85 – 88%.
- Rritja e volumit të dëmeve të paguara duke synuar vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, si dhe rritje deri në 24% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2016.
- Futja e një produkti online brenda vitit 2016.
- Informatizimi i procesit të trajtimit të dëmeve, pasqyrimi i policave në mënyrë të detajuar në sistemin informatik dhe ndërthurja e sistemit të shitjes me sistemin financiar "Financa 5".
- Projektimi dhe hedhja në treg e dy produkteve të reja brenda vitit 2016.
- Përshkrimi i funksioneve të punës dhe hartimi i procedurave për vlerësimin e performancës.

Objektivat specifike

- Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me një marketing bindës.
- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për marrjen në sigurim dhe risigurimin.
- Zbatimi i procedurave rigorozisht të përcaktuara për marrjen në sigurim me bazë riskun.
- Hartimi i një sistemi të Teknologjisë së Informacionit funksional dhe bashkëkohor për të gjitha shërbimet e shoqërisë.
- Ideimi dhe hedhja në treg e produkteve të reja; hedhja në treg e produkteve online, kryesisht atyre të shëndetit; zbatimi i politikave për uljen e produkteve me humbje teknike.
- Trajnimi i burimeve njerëzore, e kombinuar me trajnime të nivelit të mesëm operacional edhe jashtë Shqipërisë.
- Vlerësim të drejtë, të shpejtë dhe pagesë të dëmit brenda gjysmës së kohës të përcaktuar në rregullore.
- Ndjekja e një politikë konservative të shpenzimeve në tërësi, veçanërisht e shpenzimeve të përgjithshme.
- Mbajtja e një gjendjeje të shëndoshë financiare, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, aktive në mbulim të mjaftueshëm.
- Forcimi i auditimit dhe kontrollit të brendshëm.



